

## Vendim nr. 133 datë 12.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 12.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** QAMIL ÇELHAKA, përfaqësuar nga avokatët Nasi Keri, Ermal Sultafa dhe Edmond Zoto, me akt përfaqësimi.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 12-2017-941/113, datë 06.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 10-2017-2842/841, datë 21.11.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-1385, datë 14.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27-30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë (*Prokuroria Kavajë*) ka regjistruar një procedim penal në ngarkim të kërkuesit Qamil Çelhaka (*kërkuesi*), si autor i dyshuar i veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” (kundër dy ose më shumë personave), të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, i Kodit Penal (*KP*), në lidhje me ngjarjen e datës 06.12.2016, ku pas një konflikti të çastit për prerjen e një peme, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të forta çarëse, janë dëmtuar në kokë shtetasit F.Ç. dhe Y.I., si rezultat i të cilave i pari ka gjetur vdekjen, ndërsa i dyti ka pësuar dëmtime të kategorizuara si të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit po mos të jepej ndihma e kualifikuar mjekësore. Kërkuesi është arrestuar në flagrancë dhe në vijim ndaj tij është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal “Arrestimi në burg”. Në përfundim të hetimeve paraprake prokurori ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të tij.

2. Në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, në kërkesat paraprake mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar kthimin e akteve prokurorit, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, kërkesë e cila është rrëzuar nga gjykata si e pabazuar në ligjin procedural penal, në nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Në vijim, bazuar në nenin 403 të KPP-së së kohës, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar të procedohej me gjykim të shkurtuar, pra që çështja të zgjidhej në gjendjen që aktet ishin. Prokurori ka shprehur dakordësinë për këtë kërkesë dhe në vijim, mbështetur në nenin 404 të KPP-së së kohës dhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2/2003, gjykata e shkallës së parë ka vendosur të procedojë me ritin e gjykimin të shkurtuar, ndërsa ka çmuar se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që aktet ishin.

3. Në përfundim të gjykimin, me vendimin nr. 12-2017-941/113, datë 06.06.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, i KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm, ndërsa në zbatim të nenit 406 të KPP-së së kohës ka urdhëruar zëvendësimin e këtij dënimi me 35 vjet burgim. Sipas gjykatës, nga provat e grumbulluara gjatë hetimit paraprak, tashmë pjesë e fashikullit gjyqësor, provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja nga kërkuesi i veprës penale për të cilën akuzohej. Nga ana tjetër, referuar provave, gjykata nuk ka pranuar pretendimin e mbrojtjes së kërkuesit për kryerjen e veprës në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2017-2842/841, datë 21.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë

qoftë për sa i përket fajësisë së kërkuesit dhe cilësimit juridik të veprës penale, ashtu edhe të masës së dënimit të caktuar ndaj tij, duke vlerësuar se në ankimin e ushtruar nga kërkuesi nuk gjenden shkaqe që bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Edhe gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se në vlerësim dhe çmuarje të provave, në respektim të parashikimeve të nenit 152 të KPP-së, rrethanave të faktit të rezultuara në gjykim, si dhe në analizë të elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 79/dh i KP-së, në raport me veprimet konkrete të kryera nga kërkuesi, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që me veprimet e tij ka konsumuar elementet e anës objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata e apelit ka vlerësuar të pabazuar në prova pretendimin e mbrojtjes së kërkuesit për kryerjen e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Për sa u përket mangësive të pretenduara nga mbrojtja e kërkuesit në lidhje me mosmarrjen e disa provave gjatë hetimeve paraprake, gjykata e apelit ka arsyetuar se një gjë e tillë mund të realizohej gjatë gjykimit nëse do të procedohej me ritin e gjykimit të zakonshëm, por mbrojtja dhe kërkuesi kanë kërkuar të procedohej me gjykim të shkurtuar që në thelb të tij pranon aktet e grumbulluara gjatë hetimit paraprak. Gjukata e apelit ka vlerësuar të theksojë se, në situatën e mungesës së ankimit ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për të proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar, gjykimi në apel u zhvillua në respektim të parimeve të këtij lloj gjykimi të posaçëm. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësve të tij, ka paraqitur rekurs duke kërkuar prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim ose kthimin e akteve për rishqyrtim.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1385, datë 14.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se në rekurs nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, ndërsa nuk konstaton mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstaton mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, si i tillë, nuk është i cenueshëm ligjërisht.

6. Në datën 20.03.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjukata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.04.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

7.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në gjykimin e çështjes janë marrë në shqyrtim vetëm provat e sjella nga organi i akuzës, të cilat janë pranuar si të mirëqena, pa iu nënshtruar debatit gjyqësor. Organi i prokurorisë i është shmangur qëllimisht detyrimit për të mbledhur edhe ato prova që shkojnë në favor të të pandehurit, duke paraqitur para gjykatës një tablo të ndryshme nga ajo çfarë ka ndodhur realisht. Ky organ, në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, ka injoruar kërkesën e kërkuetit për pyetjen e një prej dëshmitarëve të pranishëm në vendin e ngjarjes. Po ashtu, ky parim është cenuar edhe nga gjykatat, të cilat nuk duhet të kishin proceduar me gjykim të shkurtuar, duke pasur parasysh mangësitë serioze të hetimit. Gjykata e shkallës së parë duhet të konstatonte kontradiktën mes kërkesës së kërkuetit për kthimin e akteve prokurorit dhe asaj për gjykim të shkurtuar, arsye për të cilën duhet të procedonte me gjykim të zakonshëm. Gjykatat, po ashtu, duhet të mbanin parasysh edhe ndryshimet e bëra KPP-së me ligjin nr. 35/2017, që ndalonin gjykimin e shkurtuar për veprat penale të vrasjes si në rastin konkret, për më tepër kur ky ndryshim ka hyrë në fuqi para dhënies së vendimit nga gjykata e apelit.

7.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit in dubio pro reo*, pasi gjykata e apelit e ka nisur procesin gjyqësor me bindjen se kërkueti e ka kryer veprën penale që akuzohej, duke anashkaluar faktet dhe provat materiale që provojnë të kundërtën, çka provohet nga fakti se vendimi është dhënë 5 minuta pas dhënies së konkluzioneve të mbrojtjes. Fajësia e kërkuetit nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

7.3. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka analizuar rrethanat dhe faktet e paraqitura në rekurs.

7.4. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar kur është shprehur se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Mosrespektimi dhe zbatimi i gabuar i ligjit procedural dhe atij material përbëjnë një nga shkaqet e parashikuara në këtë dispozitë. Vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik dhe

nuk përmbush kërkesat për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Ndërkohë që pretendimet e kërkuarit për çështje të ligjit kërkonin përgjigje përfundimtare, kjo gjykatë ka arsyetuar për rastet e mospranimit të rekursit, por pa analizuar rastin konkret.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në

substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 19, datë 07.07.2021; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, ndër të tjera, edhe me argumentin se gjykatat e zakonshme nuk duhej të kishin proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar, kjo nisur nga kontradikta midis kërkesës së tij për këtë formë gjykimi dhe asaj për kthimin e akteve prokurorit për shkak të mangësisë së hetimeve, përveçse edhe për faktin se ndryshimet e bëra KPP-së me ligjin nr. 35/2017, që kanë hyrë në fuqi para dhënies së vendimit nga gjykata e apelit, ndalonin këtë lloj gjykimi për veprat penale të vrasjes.

12. Në analizë të materialeve të çështjes, Kolegji vëren se ka qenë vetë kërkuesi dhe mbrojtësit e tij, të cilët, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, kanë kërkuar që gjykata të procedonte me gjykim të shkurtuar, pra që çështja të zgjidhej në gjendjen që aktet ishin, kërkesë kjo që është pranuar me vendim të ndërmjetëm të gjykatës, duke proceduar në vijim me këtë formë gjykimi. Kërkuesi nuk ka qenë dakord me vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, duke paraqitur ankim, por nuk rezulton të ketë ankimuar edhe vendimin e ndërmjetëm të asaj gjykate për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Mungesa e ankimit të kërkuesit ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë është evidentuar edhe nga gjykata e apelit, e cila ka theksuar se për këtë shkak gjykimi në apel është zhvilluar në respektim të parimeve të këtij gjykimi të posaçëm (*shih faqen 12 të vendimit nr. 10-2017-2842/841, datë 21.11.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës*). Në këto kushte, pavarësisht se kërkuesi i ka ngritur në rekurs pretendimet në lidhje me gjykimin e shkurtuar, për sa kohë nuk i ka ngritur ato para të gjitha instancave të zakonshme, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, Kolegji vëren se bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo datë kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat

elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 14.09.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues nga kërkuesi është depozituar në shërbimin postar në datën 20.03.2024. Sipas shkresës nr. 1701/1 prot., datë 03.04.2024 të Gjykatës së Lartë, të depozituar nga kërkuesi, vendimi i kundërshtuar i saj është publikuar në faqen zyrtare në datën 01.12.2023. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të prezumimit të pafajësisë e parimit *in dubio pro reo*, parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

16. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkuesi ka parashtruar si argument edhe se në gjykimin e çështjes janë marrë në shqyrtim vetëm provat e sjella nga organi i akuzës, të cilat janë pranuar si të mirëqena, pa iu nënshtruar debatit gjyqësor. Sipas tij, hetimi nga organi i prokurorisë nuk është i plotë dhe i gjithanshëm, duke mos përmbushur ky organ detyrimin për të mbledhur prova si në favor të akuzës, ashtu dhe në favor të të pandehurit, përveçse ai ka injoruar edhe kërkesën e tij për pyetjen e një prej dëshmitarëve të pranishëm në vendin e ngjarjes, në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykimi i çështjes penale kundër kërkuesit, mbi kërkesën e tij, është zhvilluar përmes rritit të shkurtuar, gjykim në të cilin gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë dhënë mundësi për të paraqitur pretendimet e veta për provat e mbledhura gjatë hetimit dhe të administruara në gjykim, për të deklaruar në lidhje me faktet, provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura ngushtë me çështjen në mënyrë të barabartë me organin e akuzës, ndërsa nuk rezulton që të jetë vënë në dizavantazh në raport me këtë organ. Po ashtu, në rrethanat kur, në mënyrë të vullnetshme, përmes pranimit të gjykimit të shkurtuar, kërkuesi ka hequr dorë nga procesi i formimit të provës në gjykim, ai nuk mund të ngrejë pretendime për sa i përket marrjes së provave tej atyre të gjendura në fashikullin e hetimit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk gjejnë mbështetje në këndvështrimin kushtetues.

18. Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se, sipas tij, Gjykata e Lartë ka analizuar faktet dhe rrethanat e paraqitura në rekurs. Në analizë të vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjen Kolegji nuk konstaton që ajo të ketë bërë vlerësim të provave dhe fakteve të çështjes. Përkundrazi, vlerësimi i saj është mbështetur tërësisht në analizën e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndaj, në kundërshtim nga sa pretendohet, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues.

19. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë ka gabuar në arsytimin e saj se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas tij, mosrespektimi dhe zbatimi i gabuar i ligjit procedural dhe atij material përbëjnë një nga shkaqet e parashikuara në këtë dispozitë. Po ashtu, sipas kërkuesit, vendimi i asaj gjykate është alogjik dhe nuk përmbush kërkesat për një vendim gjyqësor të arsyetuar, ndërkohë që pretendimet e tij për çështje të ligjit kërkonin përgjigje përfundimtare, ajo gjykatë ka arsyetuar për rastet e mospranimit të rekursit, por pa analizuar rastin konkret.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, në pjesën hyrëse, përmban palët, akuzën dhe bazën ligjore, rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, faktin se kërkuesi ka bërë rekurs dhe shkaqet e tij. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta përkundrejt parashikimeve të legjisllacionit penal

material dhe procedural, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga ato qoftë sa i përket procesit të çmuarjes së provave, ashtu edhe për sa i përket cilësimit ligjor të faktit penal të pranuar, në garantim të aksesit të kërkuesit në këtë gjykatë. Po kështu, vendimi nuk rezulton të jetë alogjik ose ketë kundërthënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk janë të argumentuara mjaftueshëm në aspektin kushtetues.

22. Nga sa më sipër, Kolegji çmon të analizojë në vijim pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë*

23. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit e ka nisur procesin gjyqësor me bindjen se ai e ka kryer veprën penale që akuzohet, duke anashkaluar faktet dhe provat materiale që provojnë të kundërtën, çka provohet nga fakti se vendimi është dhënë 5 minuta pas dhënies së konkluzioneve të mbrojtjes. Fajësia e kërkuesit nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

24. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim në jurisprudencën kushtetuese është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*)

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi asnjë dënim apo masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykatat e zakonshme janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të kërkesës, rezulton se kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria Kavajë për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, i KP-së. Akuza ndaj tij është mbështetur në një sërë provash, të tilla si: provat materiale; ekspertimet mjekoligjore të dy viktimave nga vepra penale; ekspertimi biologjikoligjor në lidhje me njollat e gjakut të gjetura në vendngjarje; ekspertimi psikiatrikoligjor i kërkuesit; deklaratimet e kërkuesit para oficerit të Policisë Gjyqësore në prani të mbrojtësit; deklaratimet e shtetasit Ç.N. i pranishëm në ngjarje; deklaratimet e shtetasve O.M. dhe G.M., që kanë shkuar menjëherë të parët në vendin e ngjarjes; deklaratimet e shtetasve H.I., bashkëshorte e viktimës nga vepra penale Y.I.; deklaratimet e prindërve të kërkuesit (shtetasve D.Ç. dhe L.Ç.). Bazuar në këto prova, prokuroria ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq.

28. Referuar provave pjesë të fashikullit të hetimit, të cilat për shkak të ritit të gjykimit të shkurtuar janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor, pas vlerësimit të tyre, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se vepra penale ishte kryer nga kërkuesi, i cili, për motive të dobëta, kishte vrarë shtetasin F.Ç. dhe kishte plagosur rëndë shtetasin Y.I., ndërkohë që ai ka qenë i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Në individualizim të dënimit, gjykata ka çmuar se kërkuesi duhej të dënohej me burgim të përjetshëm dhe se, në kushtet e shqyrtimit të çështjes përmes ritit të gjykimit të shkurtuar, ky dënim duhet të zëvendësohej me 35 vjet burgim (*shih faqet 6-7 të vendimit nr. 12-2017-941/113, datë 06.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë*).

29. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, qoftë për sa i përket fajësisë së kërkuesit dhe cilësimit juridik të veprës penale, ashtu edhe masës së

dënimin të caktuar ndaj tij. Nisur nga provat e ndodhura në dosje, gjykata e apelit ka vlerësuar se vepra penale ishte rezultat i veprimeve konkrete të kërkuesit dhe se pretendimet e tij se kishte vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme nuk gjenin mbështetje. Po ashtu, ajo ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit edhe për sa i përket masës së dënimit të caktuar ndaj kërkuesit (*shih faqet 10-12 të vendimit nr. 10-2017-2842/841, datë 21.11.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës*).

30. Në analizë të vendimeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se në rekursin e kërkuesit nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Pasi ka evidentuar se shkaqet e tij kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave të KPP-së në lidhje me vlerësimin dhe çmuarjen e provave, si dhe të dispozitave të KP-së në lidhje me cilësimin ligjor të faktit penal, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit, si gjykatë fakti dhe ligji, në analizë të shkaqeve të ankimit të paraqitur nga kërkuesi (të njëjta me ato të paraqitura edhe në rekurs) dhe brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, ka argumentuar mjaftueshëm dhe në përputhje me parashikimet e nenit 383 të KPP-së në lidhje me objektin/shkaqet e ankimit të paraqitur para asaj gjykate. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave më të ulëta janë të argumentuara plotësisht lidhur me cilësimin ligjor të faktit penal, përveçse ato kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm duke administruar dhe shqyrtuar të gjitha provat e ndodhura në dosje sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, ndërsa i gjykuari ka qenë dakord me aktet e ndodhura në fashikullin e hetimit. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka theksuar se nuk i shqyrton rekursin në drejtim të përcaktimit/provueshmërisë së fajësisë ose jo të gjykuarve, pasi kjo është një çështje që u përket gjykatave të faktit, ndërsa ajo është gjykatë ligji që kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material apo procedural penal, duke qenë jashtë juridiksionit të saj mënyra e vlerësimit të fakteve dhe provave (*shih faqet 11-13, paragrafët 11-28, të vendimit nr. 00-2023-1385, datë 14.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

31. Nga sa më lart, në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se gjykatat nuk rezultojnë të kenë filluar procesin me bindjen se kërkuesi ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Konkluzionet e gjykatave për fajësinë e tij janë mbështetur në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të administruara gjatë fazës hetimore, të shndërruara në prova gjyqësore si rrjedhojë e procedimit me gjykimin e shkurtuar. Deklarimi i fajësisë së kërkuesit rezultojnë të jetë bërë pas shqyrtimit të plotë të çështjes dhe pasi ato janë bindur se kjo fajësi provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Po ashtu, gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar në mënyrë të qartë faktet e çështjes në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë ligjore

të kërkuesit për veprimet e kryera në kundërshtim me legjislacionin penal. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.